

DHURATA SHEHRI

LIRIA E VETMISË OSE NJERIU ME VETE E PA TË TJERË

Njeriu ndalet në një shej vendi në kohë, harron punën e përditës dhe rrëmon në vete për të gjetun fillin e humbun të ndjesive të veta. Ngjan kështu që mbas secilit varg të fshihet nga një grimë ngashërimi që po në atë çast kur autori iua përcjellë të tjerëve shndërrohet në gëzim. – kështu shkruan Camaj në këmishë të kopertinës së botimit “Njeriu me vete e me të tjerë” në vitin 1978.

Gëzimi që të fal arti, domethënë gëzimi i zbulesës dhe i estetizimit të botës, rrallëherë ka prodhuar në letërsinë shqipe kaq shumë liri e vetmi sa në poezinë e Martin Camajt. Është fjala, mitra e kësaj lirie dhe vetmie. Tek Camaj fjala është ndërtuese dhe përshkruese e botës. Është e thellë sa qenia e poetit dhe e gjerë sa bota e tij. Poezia e Camajt i jep një kuptim të ri fjalës, e risemantizon dhe e përdor vetëm atëherë kur është e nevojshme. Në poetikën e tij kundërvënja mes botës reale dhe botës së estetizuar e të esencializuar shfaqet me “mosprani” që është njëherësh pritje për një të vërtetë të epërme, të vërtetën e artit, dhe habi për zbulimin e saj, thellë brenda vetes. Prandaj ngjarjet e jashtme, bëhen gjithnjë e më të pangjashme me veten në këtë botë të re ku hapësira dhe koha shndërrohen në përmasa psikike. Kjo poetikë e kërkimit të thelbësorës tek Camaj vjen shkallë-shkallë e hap pas hapi, nga vëllimi i parë deri tek dorëshkrimet e fundit. Fjala, gjithnjë e më shumë, merr thellësinë e vetmisë. Raportet mes imazheve nuk kanë ngjashmëri me botën reale. Dukshëm, krahasimet zëvendësohen me metafora të largëta, të vështira për t’u interpretuar, foljet kalojnë në kohë gjithnjë e më të shkuar, fjala bëhet gjithnjë e më aluzive dhe e vetmuar në esencën e vet. Theksimi i kësaj poetike nga vëllimi në vëllim duket që tek ndryshimet që kanë pësuar poezitë e përfshira së pari tek vëllimi *Kanga e vrrinit* (1954) dhe më pas në vëllimin *Lirika mes dy moteve* (1966). Njëzet e një nga 47 poezitë e vëllimit *Kanga e vrrinit* rimerren në vëllimin *Lirika mes dy moteve*: (renditja është e vëllimit *Kanga e Vrrinit*) 1. *Tingujt e parë* 2. *Kur kërcen Dila*; 3. *Flaka e shtutës*; 5. *Deshta një vazhë*; 8. *Pa titull*; 9. *Kanga në mjesditë*; 10. *Zadja te kroni*; 11. *Pa titull*; 12. *Dashuni e prendume*; 16. *Tregimi i vashës*; 17. *Kallzimi i blegës së vjetër*; 21. *Nji vjetë*; 24. *Vjeshtat e mixhës*; 28. *Rruga bri lumit*;

30. Shpella e shtektarëve; 37. Lahuta e vjetër;; 38. Kanga e korrtares; 40. Xhelozija; 44. Rrashta; 45. Andrrimi i korbit; 46. Hija e lisit)

Pothuaj të gjitha këto poezi, janë rindërtuar në frymën e poetikës së estetizimit dhe të esencializimit e kjo ndjehet në krahasimet mes dy varianteve të disa poezive si më poshtë:

<i>dy ruba të kuqe si flaka e zjarmit.</i>	<i>dy flaka zjarrmi- (Kur kërcen Dila)</i>
<i>Si mbushet mali, fusha, me bar n'prill.</i>	<i>Nji mugullim nën diellin e ndezët n'prill (Flaka e shputës – pishës)</i>
<i>Fluturova si blea në rrezet e para n' ajr</i>	<i>Fluturova mbi flatrat e mallit mbi flatrat e ndjenjes (Deshta një vajzë)</i>
<i>frymës s'eme n'muzg,</i>	<i>e frymës së qershorit n'muzg (Deshta një vashë)</i>
<i>kujton e thotë endë:</i>	<i>e kujtoi e tha: Dam (Vjeshtat e Mixhës)</i>
<i>Lahuta flet, mandej vajton me dridhjet e zanit të mixhës si qyqja n'pranverën e parë, tash gjarpni i gdhendun në të leviz dhe trimat mbi gjoka me shpata t'hjekna fluturojn' n' për zhark... -</i>	<i>E me dridhjen e zanit të mixhës gjarpni i gdhendun në të lëviz dhe trimat me gjoka e shpata fluturojnë për zhark (Lahuta e vjetër)</i>
<i>e i djegun fshani! Iku pllumbi i egër në mal e në çerdhen e vjetër gjet nji pupël të saj, nji lodje i ra mbi të si vesa e natës mbi bar. (Xhelozija)</i>	<i>Fluturoi mbas rrezeve të fundit ra në diell e u dogj.</i>
<i>Mbas shiut ra dielli e zogun e madh po e nxe para shpelle – në rrasë. – e nxente Tue qitun avull korbi vendin andrron mbi maje, n'qiell pa rê – andrroi ai veten (Andrrimi i korbit – Andrra e korbit)</i>	

Kemi të bëjmë pra me një proces estetizues të botës, gjurmët e të cilit duken më qartë se kudo në shndërrimin që ka pasur një cikël i tërë poezish në dorëshkrim, i cili kur botohet, del i dendësuar në një poezi të vetme. Poezitë e dashurisë: *Pesha, Me ty, Fati, Kështjelli mbi ujë, Gazi i ndalun,*

Liria e vetmisë ose njeriu me vete e pa të tjerë

Po s'erdhe ti, Ngritja, Agimi i ditës së re, E vetmja dritore që i lidh në trajtë cikli, objekti i tyre, Hera, personazhi i dashur, por edhe disa poezi të tjera dashurie që nuk e kanë personazh Herën: *Trupth i vogëlith, Pyetja e prapandjenjës, Pyetje, Kthimi i anijes, Pa lamtumirë, Po të bie një libër, Nji mendim, Uji* që janë të së njëjtës atmosferë, estetizohen e esencializohen e ngjeshen në një poezi, në atë me titull *Ai mal akulli ndan kohën*.

Rrugëtimi drejt esencializmit dhe estetizimit të motivit të dashurisë duket qartë po të krahasojmë poezinë *“Moj e mira”* (1953) me poezinë hyrëse të ciklit *“Hera”* (1968) dhe më tej me poezinë *“Ai mal akulli ndan kohën”* (1978) të tria me të njëjtin motiv dashurie.

Moj e mira „Moj e mira, vetull-zezë, Zemrën krejt, moj, m'a ké ndezë! S'gjindet njëri me m'a shkimun Uji i bjeshk's as bora e ngrimun. Ti më jé, moj era e luleve, Ti më jé, moj, flladi i lugjeve. Nuk të ndroroj me hyjt e qiellit, Syni yt si rrezja e diellit, Balli i yt si balli i hanës, Shtati i yt si shtati i zanës. Lulja e bjeshk's t'a ka lakmi Kur qesh ambël plot hieshi. Zâni i yt si zâni i malit Nuk të lshoj o për së gjallit; (Një fyell ndër male, Prishtinë 1953)	Hera (Ai mal akulli kishte një emën e s'mund ta thom, ai mal akulli kishte një emën tabú.) Para se të mbylleshin sytë në gjumë, Hera, pashë malin e akullit të bardhë te kambët e mia Hera e fortë, shkrije akullin te kambët e mia me diell, Hera! e qitni një bimë të blertë aty te kambët e mia Mos e le akullin të rritet Ndër netët e ftofta e të preki kambët e mia. Në kohën e hijeve më merr në gj deri në dritë, Hera! Me zemër të flakët e me diell, me trup të blertë, Hera, deri në dritë me mue.	Ai mal akulli ndan kohën (Ai mal akulli kishte një emën një emën tabú.) Para se të mbylleshin sytë në gjumë, pashë malin e akullit të bardhë te kambët e mia. Erdhi era me diell dhe e shkrini e aty nën hijen time doli një bimë. (Njeriu me vete e me të tjerë”, Mynih 1978)
--	--	--

DHURATA SHEHRI

	(Ai mal akulli kishte një emën e s'mund ta thom, ai mal akulli kishte një emën tabú.) (Dorëshkrim, Mynih, 1968)	
--	---	--

Largimi nga tradita bëhet, ngadalë, shkallë-shkallë, me një hap të matur e të baraspeshuar, por pa e fyer atë. Ky largim nga tradita, është së pari largim nga vendlindja ose nga vendi (vëreni zëvendësimin *vend-vetvete*), por duke e themeluar një vend të vetin, vend të të gjithëve, poezinë. Më tej shikojmë si treten nana, baba, vrrini, fyelli dhe në sfond kjo muzikë, poezia (sidomos tek *Nji fyell ndër male*). Krejt ndryshe ndodh në krijimet e para: poeti aty kujdeset më shumë ta fiksojë atë botë e ta marrë me vete nga frika e humbjes, i frikur se me zhbërjen e saj do të zhbëhej edhe ai vetë. Më pas vetë kujtimi e tëhuajson poetin, por edhe tëhuajsohet. Frika e humbjes së vendlindjes ia zë vendin frikës së humbjes së vetvetes, prej nga do ta rikrijojë edhe një herë, botën, edhe të vetën, në një përmallim estetizues për sendet (*Emnimi i sendeve*), njerëzit, ndjesitë, idetë, frymën. Ajo që fillimisht është një poezi jehonash që risjell në vetvete jehonat e vendit, sidomos në periudhën e parë tek “Një fyell ndër male” e “Kanga e vrrinit” shndërrohet më pas në poezinë e qenies estetike që botën e thelbëson duke e shndërruar në vepër arti. Dallimi është i dukshëm edhe në nivel figurativ. Malli, një ndër elementët thelbësorë të dy vëllimeve të para, në vëllimin “*Njeriu me vete e me të tjerë*” merr trajta metaforike të pastra:

*Lyp dashuninë e syve të mbyllun
dy molla të tejpushme
me bërthamë zjarrmi në mes (Malli për jetë)*

*Uliksi e Itaka pa grue – dy krena binjokë dhie
me nji bri të thyem: punë e pakryeme (Çka i duhet Uliksit Itaka pa grue?)*

Ose lahuta e mixhës tek “**Lahuta e vjetër**” merr këtë trajtë tek “**Mysafir i papritun në Berishë**”:

Fillimi e mban zemrën pezull

Liria e vetmisë ose njeriu me vete e pa të tjerë

jo sosja e kangës...

Edhe poezia e pejsazheve shndërrohet në frymë, që tokën e mallit e të kujtimit e estetizon dhe esencializon me sytë e poetit. Fjalët metaforike *flakë*, *rrajë* e *dele* marrin kuptime të reja, risemnatizohen:

Syni kërkon **flakën** e fshehtë
vjedulla strofkullin
në gji të **rrajve** dhe kujton
ngrohtësinë e frymës
nën lëkurën e **deles** së bardhë. (Dimën)

Shembulli më i pastër i këtij procedimi ndjehet tek poezia “Nën hijen e sendeve”:

Nën hije ku sot mbasdite pushova
e këputa fije bari n’mendim
cicrrojnë bujqit e natës.

Pranë votre ndigjoj plasje
bishtajzash
gjineshtre në parzëm. (Nën hijen e sendeve)

Në vëllimin e fundit me poezi që Camaj do të botojë në të gjallë të vet “*Palimpsest*”, poetika e estetizmit dhe esencializmit do të shndërrohet në poetikë të palimpsestit. Shtesat e nënvetëdijes poetike të shfaqura si jehona në vëllimet e para, të esencializuara e estetizuara si kujtime e të shndërruara në nominativë bote në vëllimet e mëpasme, në vëllimin e fundit “*Palimpsest*” shndërrohen në shresa përbërëse që nuk neutralizojnë njëra-tjetrën, por lënë të ndërduhet të gjithë përbërësit e poetikës së tij të palimpsestit duke u mbivendosur në varg nga poezia e parë në të fundit të vëllimit (Shkroja nistore në palimpsest; Fjala; Enigma; Hoja etj)

Poezia e Camajt kalon nëpër rrugën e gjatë dhe të vështirë të një largimi të shumëfishtë nga vendi, nga tradita dhe nga poezia bashkëkohëse që shkruhej në Shqipëri. Gabimisht Camaj receptohet sot si tradicionalist, por ai është larguar nga tradita dalëngadalë e shumëfishëm që nga vëllimi *Kanga e vrrinit* e deri tek cikli i dorëshkrimeve të fundit. Pikërisht tek këto dorëshkrime të fundit e gjejmë një të ngjashëm të vet në këtë largim e gëzim drejt vetmisë së krijimit:

DHURATA SHEHRI

*Zemrat njerëzore i mbylle
me druj çeliku para vetes
Vetmitar mes njerëzve të tu
shujtoheshe me frytet e heshtjes
e na solle shpinën ftohtas
uue me shokë, pa kend tonin
në një literaturë (Mjedjes)*

Rruga e poezisë së tij është rruga e mundimshme e kthimit në atdhe të një autori të penguar nga të gjithë. Ai vjen vetëm, me gegnishten e larguar nga vetë gegnishtja e ndaluar, me poetikën e vet të larguar nga tradita shkodrane edhe kjo e ndaluar, me poezinë e tij moderne e vetjake krejt të huaj për poezinë vokalike, për tërmetin verbal me shumë epiqendra, për poetikën kolektive të realizmit socialist. Në këtë kënd ajo ka karakteristikat e fisnikërisë që Montale i njeh poezisë: plotësisht e padobishme, por asnjëherë e dëmshme.